


# Qumështi dhe Nënproduktet e tij

## Viti 2022

**Tiranë, më 06 Korrik 2023:** Në vitin 2022, sasia gjithsej e qumështit të grumbulluar rezulton rreth 110 mijë tonë. Gjatë kësaj periudhe, sasia e qumështit të lopës të grumbulluar është rreth 87 mijë tonë, duke pësuar rënie me rreth 7,8%, krahasuar me 2021. Sasia e grumbulluar e qumështit të deles, në vitin 2022, është rreth 14 mijë tonë, duke shënuar rritje me rreth 9,7%, krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë, sasia e grumbulluar e qumështit nga dhitë është rreth 9 mijë tonë, duke shënuar rritje me 18,7%, krahasuar me vitin 2021.

Fig. 1 Sasia e qumështit të grumbulluar sipas llojeve 2021 – 2022, (mijë tonë)



**Burimi:** Anketa e qumështit dhe nënprodukteve të tij, INSTAT

Nga sasia gjithsej e qumështit të grumbulluar, rreth 13 mijë tonë është përdorur për prodhimin e qumështit për konsum njerëzor, pjesa tjetër shkon për përpunim. Struktura e qumështit të prodhuar për konsum paraqitet si më poshtë: qumështi i plotë i përpunuar 85,8%, qumështi gjysëm i skremuar 10,6%, qumështi i papërpunuar 3,1% dhe qumështi i skremuar 0,5%.


**Për publikim 06/07/2023**

Tab. 1 Sasia e qumështit, kemit dhe kosit të prodhuar për konsum 2020 - 2022, (tonë)

Nr.	Produktet	Vitet		
		2020	2021	2022
<b>1</b>	<b>Qumësht për konsum</b>	<b>16.774</b>	<b>13.955</b>	<b>13.100</b>
1,1	Qumësht i papërpunuar	239	484	404
1,2	Qumësht i përpunuar	13.799	12.106	11.244
1.2.1	I pasterizuar	13.571	11.753	10.887
12,2	UHT	228	353	357
1,3	Qumësht gjysëm i skremuar	2.699	1.271	1.391
1.3.1	I pasterizuar	1.977	722	941
1.3.2	UHT	722	549	450
1,4	Qumësht i skremuar	37	94	60
1.4.1	I pasterizuar	37	94	60
1.4.2	UHT	-	-	-
<b>2</b>	<b>Krem</b>	<b>345</b>	<b>332</b>	<b>187</b>
2,1	Më pak se 29 %	343	322	176
2,2	Më shumë se 29 %	2	10	11
<b>3</b>	<b>Qumësht i acidifikuar (kos, dhallë, etj)</b>	<b>20.342</b>	<b>15.134</b>	<b>12.879</b>

Burimi: Anketa e qumështit dhe nënprodukteve të tij, INSTAT

Fig. 2 Struktura e djathit të prodhuar sipas llojit të qumështit 2021 – 2022, (%)



Burimi: Anketa e qumështit dhe nënprodukteve të tij, INSTAT

**Nënproduktet e qumështit**

Sasia e prodhuar e djathit gjithsej pësoi rënie me 3,8%. Ndërkohë, djathi i prodhuar nga qumështi i dhisë shënoi rritje me 17,1 %, djathi i prodhuar nga qumështi i deles shënoi rritje me 7,3 % ndërsa djathi i prodhuar nga qumështi i lopës pësoi rënie me 9,1 %.

**Tab. 2 Nënprodukte të qumështit 2020 - 2022, (tonë)**

Produktet	Vitet		
	2020	2021	2022
<b>Gjalpë dhe produkte të tjerë yndyrorë</b>	<b>810</b>	<b>783</b>	<b>783</b>
Gjalpë (Tradicional)	790	763	744
Gjalpë i shkrirë	20	20	39
<b>Djathë (sipas origjinës)</b>	<b>11.712</b>	<b>13.114</b>	<b>12.618</b>
Djathë nga qumështi i lopës	8.815	9.492	8.628
Djathë nga qumështi i deles	1.958	2.560	2.747
Djathë nga qumështi i dhisë	939	1.062	1.243
<b>Djathë i përpunuar</b>	<b>464</b>	<b>436</b>	<b>403</b>

**Burimi:** Anketa e qumështit dhe nënprodukteve të tij, INSTAT

Struktura e djathit të prodhuar sipas fortësisë për vitin 2022, është: djathë i butë 54,2%. djathë gjysëm i fortë 23,3%, të tjera prodhime të freskëta 14,0% dhe djathë i fortë 8,5%.

**Tab. 3 Sasia e djathit të prodhuar sipas fortësisë 2020 - 2022, (tonë)**

Produktet	Vitet		
	2020	2021	2022
Djathë i butë	6.555	5.431	6.846
Djathë gjysëm i fortë	3.432	3.395	2.935
Djathë i fortë	1.858	1.026	1.078
Të tjera prodhime të freskëta (gjizë qumështi, salcë kosi etj.)	1.745	1.861	1.760

**Burimi:** Anketa e qumështit dhe nënprodukteve të tij, INSTAT

# Metodologjia

Anketa e qumështit dhe nënprodukteve të tij është një vërtetim statistikor që kryhet pranë ndërmarrjeve të cilat grumbullojnë dhe përpunojnë qumësht në territorin e Republikës së Shqipërisë. Objektivi kryesor i vërtimit vjetor të qumështit është të japë informacion të plotë për sasinë e qumështit të grumbulluar (të gjitha llojet e qumështit) dhe të nënprodukteve të tij.

Të dhënat për qumështin e grumbulluar dhe nën produktet e prodhuara. objekt i këtij publikimi i përkasin vetëm sasisë që përdoret nga industria e cila zë vetëm një pjesë të prodhimit gjithsej të qumështit të njësisë ekonomike bujqësore. Ndërkohë që e gjithë sasisa e qumështit të prodhuar shpërndahet në disa kategori si më poshtë:

- Ushqim për blegtorinë
- Vetkonsum i freskët (nga fermerët)
- Përpunim në fermë
- Shitje direkt konsumatorit
- **Shitje industrisë**

Zgjedhja e kampionit u bazua në aktivitetin ekonomik të ndërmarrjes sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike Rev2. Anketa e Qumështit dhe Nënprodukteve të tij është një vërtetim ku janë të përzgjedhura të gjitha ndërmarrjet që grumbullojnë dhe përpunojnë qumësht.

Burimet e përdorura për përzgjedhjen e kampionit:

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
- Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve. INSTAT

Periudha referuese: Të dhënat e Anketës për Qumështin dhe Nënproduktet e tij i referohen vitit kalendarik 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022.

Mbledhja e të dhënave në terren bëhet përgjatë një muaji dhe të gjitha ndërmarrjet e zgjedhura u anketuan nëpërmjet intervistës së drejtpërdrejtë.

Përkufizimet janë në përputhje me rregulloret dhe vendimet e Eurostat (Vendimi i Komisionit Nr 97/80/EC. Direktiva e Këshillit 96/16/EC. Aneksi 1).

Qumështi i papërpunuar (të gjithë llojet) dhe kremi i mbledhur nga të gjitha fabrikat që blejnë qumësht (të gjithë llojet) dhe krem direkt nga fermerët apo nga prodhimi vet. Përfshinë shumën e mbledhur të qumështit të papërpunuar (të gjithë llojet) në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Përmbajtja e yndyrës dhe proteinave në qumësht (të gjithë llojet) dhe kremi i cili është mbledhur gjatë vitit referues shfaqet si një përqindje e përmbajtjes mesatare.

Sasitë e prodhuara të produkteve të qumështit. Të dhënat përfaqësojnë shumën e të gjitha produkteve të qumështit të prodhuara gjatë vitit referues.

**Qumësht për konsum:** është qumështi që prodhohet për konsum në paketim 2L ose më pak.

Përfshin qumështin e papërpunuar. qumështin e përpunuar. qumështin gjysëm të skremuar. qumështin e skremuar.

**Dhallë:** është produkt i mbetur (mund të jenë acid ose acidifikuar) i përpunimit të qumështit ose kremit në gjalp.

**Krem:** një shtresë yndyre që formohet në mënyrë natyrale në sipërfaqen e qumështit. Përftohet duke e skremuar nga sipërfaqja e qumështit ose nxirret nga qumështi nëpërmjet procesit të centrifugimit. Kremi ka një përmbajtje të lartë yndyre (zakonisht mbi 10 %), Përfshin kremin e drejtpërdrejtë për konsum. që përmban më shumë ose më pak se 29 % e yndyrës së qumështit.

**Produkte të qumështit të acidifikuara:** përfshinë kos. kos të pijshëm. qumësht i acidifikuar. qumësht dhe produkte të tjera të acidifikuara.

**Gjalpë dhe produkte të tjerë yndyrorë:** janë produkte me një përmbajtje yndyre qumështi barabartë me 82 % të peshës së produktit. përmbajtje uji jo më shumë se 16 % dhe përmbajtje materiali jo yndyror prej 2 %.

**Djathë të freskët ose të stazhionuar.** të ngurtë apo gjysëm-të ngurtë të përfuar nga koagulimi/mpiksja e qumështit të skremuar. gjysëm të skremuar. kremit. kremit të hirrës veçmas ose në kombinim nga veprimi i farës së djathit ose agjentëve të tjerë të përshtatshëm të koagular/mpiksuar dhe nga tharja e pjesshme e hirrës që përftohet nga koagulime/mpiksje të tilla.

**Djathë i butë:** djathë në të cilin përmbajtja e lagështisë mbi bazën pa yndyrë pas rafinimit është jo më pak se 68 %.

**Djathë gjysëm i butë:** djathë në të cilin përmbajtja e ujit mbi bazën pa yndyrë pas rafinimit është më shumë se 62 % dhe më pak se 68 %.

**Djathë gjysëm i fortë:** djathë në të cilin përmbajtja e ujit mbi bazën pa yndyrë pas rafinimit është më shumë se 55 % dhe më pak se 62 %.

**Djathë i fortë:** djathë në të cilin përmbajtja e ujit mbi bazën pa yndyrë pas rafinimit është më shumë se 47 % dhe më pak se 55 %.

**Djathë shumë i fortë:** djathë në të cilin përmbajtja e ujit mbi bazën pa yndyrë pas rafinimit është më pak se 47 %.

**Djathë i freskët:** produkti i përftuar nga fermentimi i qumështit nga i cili shumica e ujit është hequr. Gjithashtu përfshihet gjiza (përveç në formë pluhuri) më përmbajtje më shumë se 30 % ndaj peshës në formën e sheqerit dhe frutave të shtuara.

**Djathë i përpunuar:** produkti i përftuar nga bluarja, përzierja, shkrirja nën veprimin e nxehtësisë dhe me ndihmën e agjentëve të përzier të një apo më shumë llojeve të djathit, me ose pa shtimin e përbërësve të qumështit dhe/apo ushqimeve të tjera.